



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:036482
Datë: 18.12.2023
Numri i dokumentit: 05082189

C-III.-12-0168

Parashtruesi i ankesës:

1.R Q,
2.H D Q,
3.H Q,
4.R Q,
5.L Q,
6.A Q,
7.A Q,
8.A Q , të gjithë nga Prizreni.

Kundër

Pala kundërshtare:

Ndërmarrja Shoqërore “Progres-Export”, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme) gjyqtarja Manushe Karaçi më 15 dhjetor 2023, lëshon këtë:

AKTVENDIM

- I. Ankesa e parashtruesit hedhet poshtë si e papranueshme.**
- II. Në këtë çështje juridike nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Më 23 shkurt 2012, Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës, nga Gjykata Komunale në Prizren, ka pranuar lëndën me nr. C. Nr. 509/01 të datës 12 dhjetor 2011 pas plotfuqishmërisë

së aktvendimit, në kompetencë të mëtutjeshme.

Më 4 shtator 2001, Gjykata Komunale në Prizren ka pranuar padinë e parashtruar nga paditësit R Q dhe të tjerët kundër të paditurit KBI “Progres-Export” Lavërtari dhe Blegtori për prishjen e kontratës mbi shitblerjen.

Paditësit kanë kërkuar nga gjykata që të vërtetohet si e pavlefshme kontrata mbi shitblerjen me nr. 11647/9 e datës 3 mars 1965, e lidhur ndërmjet Q N H dhe KBI”Progresi” si blerës, si dhe e paditura të kompenzojë shpenzimet e kontestit në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Si dëshmi për pretendimet e lartcekura parashtruesit për gjykatën kanë dorëzuar provat vijuese:

- *Kopjen e kontratës me numëre datës....;*
- *Kopjet e certifikatave të lindjes së paditësve;*
- *Kopjen e certifikatës së vdekjes për Q N dhe aktvdekjen;*
- *Autorizimin e dhënë nga paditësit për av. S T, më 25 maj 2012*

Më 12 dhjetor 2011 Gjykata Komunale në Prizren ka nxjerrë Aktvendimin C.nr.509/01 me të cilin është shpallë jokompetente në pikëpamje lëndore për të vepruar në këtë çështje juridike. Pas plotfuqishmërisë së aktvendimit padia dhe shkresat e lëndës iu janë përcjellë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në kompetencë të mëtejme

Më 25 maj 2012, i autorizuar i paditësve ka dorëzuar pranë Dhomës së Posaçme, korrigjimin e padisë për vërtetimin e pronësisë dhe kthimin e patundshmërisë në vlerë prej 3500 euro.

Përfaqësuesi i paditësve deklaroi se e ndjera Q H, respektivisht gjyshja e paditësve ka qenë pronar dhe posedues e ngastrës kadastrale ..., në sipërfaqe prej 0,22,50 ha, arë e klasës III, me fletë poseduese nr. ... KK S e E, për të cilën ka bërë tjetërsimin me kontratën e shitblerjes Leg ...e datës....., prej të cilës patundshmëria e lartcekur është evidentuar si pronë e KBI”Progres” për krijimin në atë kohe të ashtuquajtura “F të P”.

Më tej, përfaqësuesi i paditësve theksoi se kontrata e lartcekur është nënshkruar nën presione të ndryshme dhe me kërcënime se e ndjera H e cila ka qenë e punësuar në Sipërmarrjen “Sharr” do të mbetet pa punë.

Kësisoj paditësit kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpafia e paditësve, ashtu që të vërtetohet si e pavlefshme Kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë Leg. Nr. ...e datës e mars ... lidhur ndërmjet Q N H ,ish, dhe KBI “Progres”, si dhe paditura të detyrohet që ta pranojë dhe lejojë regjistrimin në librat e kadastrit të KK Prizren në emër të paditësve në ngastrën kadastrale nr....., me sipërfaqe 0,22,50 ha, arë e klasës së III. Fleta poseduese nr... KK S e E, ose të ia kompenzojë me patundshmëri adekuate dhe të bëjë dorëzimin në posedim e shfrytëzim të lirë si dhe të paguajë shpenzimet e procedurës.

Poashtu, paditësit propozuar që lënda t’i delegohet Gjykatës Komunale në Prizren në vendosje. Më 2 nëntor 2011,AKP-ja ka dorëzuar mbrojtjen e vet, me anë të së cilës ka theksuar se padia e parashtruar nga paditësit është në kundërshtim me parimin procedural- **legitimacio ad causam**, i cili ka të bëjë me legjitimitetin real qoftë atë aktiv ose pasiv.

Më tej, AKP-ja konsideron se ka kaluar afati i paraparë me ligj (afati subjektiv 1 vit dhe afati objektiv 5 vite) për të kërkuar anulimin e kontratës së rrëzueshme, pasi që kjo kontratë është lidhur para disa dekadave. Ndërsa, sa i përket referimit të lëndës në Gjykatën Komunale në Prizren, AKP-ja deklaroi se pretendimi i tillë është i pa bazuar në ligj.

AKP-ja përmes mbrojtjes së saj kërkon nga Dhoma e Posaçme që të hedhet poshtë padia e paditësve si e papranueshme ose të refuzohet si e pabazuar kërkesëpafia e paditësve, me të cilën kanë kërkuar të anulohet Kontrata e shitblerjes, Leg ...e datës

Më 23 shkurt 2023, Dhoma e Posaçme ka lëshuar një urdhër për paditësin që në afat prej 30 ditëve të dorëzojë Dëshmi (Aktvendimin e trashëgimisë), se është shqyrtuar pasuria trashëgimore, apo se është dukë u zhvilluar procedura për shqyrtim të trashëgimisë së paraardhësve të tyre, për ta vërtetuar legjitimitetin real aktiv të trashëgimtarëve paditësve në procedurë.

Në bazë të fletëkthesës gjykata vëren se paditësi e ka pranuar urdhrin e gjykatës me 27 mars 2023 por gjer më sot nuk ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar. Në bazë të shkresave të lëndës gjykata merr përsipër çështjen e legjitimitetit aktiv i cili është element që Neni 28.2.3 i Shtojës së Ligjit nr. 04/L-034 e përcakton si bazë për pranueshmërinë e ankesë.

Arsyetimi Ligjor:

Ankesa e parashtruesit hedhet poshtë si e papranueshme.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr. 06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në kuptim të nenit 76.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktvendim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësia apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese).

Pika 3 e këtij neni parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Dhoma e Posaçme, pasi që shqyrtoi ankesën e dorëzuar dhe shkresat e tjera të lëndës konstatoi se ankesa duhet të hedhet poshtë si e papranueshme. Neni 36 paragrafi 2 pika 2.5 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se *”kërkesa/ ankesa është parashtruar në pajtim me nenin 33 dhe 35 të këtij ligji”*.

Neni 35 paragrafi 2 pika 2.4 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, përcakton se ankesa duhet të përmbajë: *“lëndën dhe të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën, bazën për juridiksionin parësor të Dhomës së Posaçme në lidhje me kërkesën apo ankesën, argumentet ligjore mbi të cilat mbështetet kërkesa apo ankesa dhe një listë provash që parashtruesi synon t'i paraqes”*.

Gjykata vëren se Parashtruesi me ankesë për gjykatën ka prezantuar: *Kopjen e kontratës me numëre datës....., Kopjet e certifikatave të lindjes së paditësve, Kopjen e certifikatës së vdekjes dhe aktvdekjen.*

Parashtruesi kërkon nga gjykata të vërtetohet si e pavlefshme Kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë Leg. Nr.e datës e mars si dhe paditura të detyrohet që ta pranojë dhe lejojë regjistrimin në librat e kadastrit të KK Prizren në emër të paditësve në ngastrën kadastrale nr...., ose të ia kompenzojë me patundshmëri adekuate dhe të bëjë dorëzimin në posedim e shfrytëzim të lirë Megjithatë parashtruesit lidhur me vërtetimin e legjitimitetit real aktiv nuk kanë prezantuar për gjykatën provat relevante.

Parashtruesit gjykata i bën me dije se sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë t'i paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla.

Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Për më tepër edhe në bazë të nenit 31, paragrafi 1 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës i cili përcakton se: *‘Palët, në parashtrësia e tyre me shkrim, duhet të paraqesin një pasqyrë gjithëpërfshirëse të fakteve që ato palë i dinë, apo me arsye besojnë të jenë relevante apo materiale për kërkesën, lëndën, procedurën apo rastin përkatës’*.

Me nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës parashihet që: *‘në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore’*.

Me nenin 36, paragrafi 3 i Ligjit Nr. -6-l-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës i cili përcakton se : *Nëse Gjyqtari i vetëm apo Kolegji, vlerëson se kushtet e përcaktuara me paragrafin 2 të këtij neni nuk janë përmbushur, atëherë ai hedh poshtë kërkesën/ankesën në baza të papranueshmërisë si dhe saktëson në hollësi bazën ligjore për refuzimin e tillë. Nëse kërkesa/ ankesa refuzohet vetëm për shkak se nuk i përmbahet nën-paragrafi 2.5 të këtij neni, atëherë Gjyqtari i vetëm apo Kolegji do t'i lëshojë një urdhër paditësit me të cilin saktësohet afati i arsyeshëm kohor brenda të cilit Paditësi mund të korrigjojë gabimet dhe prapë të parashtrtojë kërkesën/ankesën.*

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku në pajtim me nenin 33 paragrafi 1 dhe nenin 36 paragrafi 2 pika 2.3 e Ligjit për Dhomën e Posaçme vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Shpenzimet Gjyqësore:

Duke u bazuar në Nenin 62 paragrafi 5 i Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.

**GJYQTARJA,
Manushe Karaçi**